



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/05/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. F.L ndaj gjyqtares L.K, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 27.03.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. F.L ndaj gjyqtares L.K, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Av. F.L me datë 13 Mars 2024 ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.K. Me datë 15 Mars 2024 lidhur me ankesën është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Mbrojtësi i të pandehurit F.M, av.F.L, me parashtresën e datës 13.03.2024 ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares së çështjes L.K dhe fillimin e procedurës disiplinore për të njëjtën me arsyetimin se në seancën të shqyrtimit gjyqësor të datës 30.11.2023, dëshmitarja — e dëmtuara ka deklaruar se dhunimi ka ndodhur me datë 13.06.2022 (e evidentuar edhe në procesverbal). Gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndodh një pauzë e shkurt prej presë (5) minuta, ku i mbrojturi i tij kërkon që të shkoj në wc, ndërsa as trupi gjykues dhe as palët e tjera nuk kanë lëvizur nga vendet. Sipas parashtruesit të ankesës av. F.L, gjatë kësaj pauze Prokurori i Shtetit Ruan Salihu, ja jep një letër kryetares së trupit gjykues L.K në prezencë të të gjitha palëve, po ashtu edhe në prezencë të anëtarëve trupit gjykues Elife Uka ishte ulur në anën e djathtë, ndërsa në anën e majtë ishte i ulur gjyqtari Adnan Isufi, ku të dytë e kanë parë dorëzimin dhe pranimin e letrës. Pas kthimit nga pauza, sipas tij Kryetarja e trupit gjykues insistonte tek e dëmtuara – dëshmitarja në lidhje me datën 13.06.2022 të cilën e njëjta e deklaroi ku e njëjta edhe pas pyetjeve të kryetares së trupit gjykues përsëri e jep të njëjtën datë. Pas kësaj, sipas tij Kryetarja e trupit gjykues i drejtohet prokurorit me fjalët “Skom qka i boj, qashtu po deklaron”, duke lënë të nënkuptohet se e njëjta po mundohet të interferoj në përgjigjet e palës së dëmtuar. Ndër të tjera ka deklaruar se gjykata nuk i ka respektuar palët në mënyrë të barabartë e ky është fakt i pakontestueshëm, sepse sipas tij nga seanca e shqyrtimit fillestar e deri në seancën e fundit pala e dëmtuar së bashku me prindërit e saj dhe me avokatin kanë hyrë në seancën nga hyrja zyrtare së bashku me trupin gjykues, veprim i cili sipas parashtruesit të ankesës ka ngjallur

dyshim se mos trupi gjykues po koordinohet para hyrjes dhe po ndikohet nga pala e dëmtuar, pasi që të njëjtën po e trajton me shumë respekt. Ka propozuar që në lidhje me këtë të shikohen kamerat e korridorit të gjykatës. Më tej ka shtuar se kryetarja e trupit gjykues, gjatë gjithë marrjes në pyetje të palës së dëmtuar nga ana e avokatit mbrojtës të pandehurit ndërhyjnë në pyetje si dhe i ndalon të bëjë pyetje, përkundër asaj që as Prokurori i Shtetit e as përfaqësuesi i palës së dëmtuar nuk i kundërshtonin pyetjet e avokatit. Pra sipas tij gjykata merr rolin aktiv, përkundër asaj që gjykata në çështjen e administrimit të provave ka rol pasiv, po ashtu se a është e lejuar apo jo një pyetje, bëhet vetëm pas propozimit të prokurorit, e assesi që trupit gjykues ex officio, pasi që në opinion por edhe për palët krijohet perceptimi që po ja mban anën palës së dëmtuar.

Ndër të tjera ka deklaruar se në seancat e mbajtura me datë 22.04.2024 dhe me datë 11.03.2024 të gjitha propozimet e parashtruara nga avokati mbrojtës i të pandehurit janë refuzuar nga ana e trupit gjykues, ndërsa janë aprovuar propozimet e prokurorisë në lidhje me prova që kanë vlerën e njëjtë me provat e parashtruara nga avokati mbrojtës, duke bërë kështu që të shihet qartë animi i kryetares së trupit gjykues por edhe anëtarëve të trupit gjykues dhe jo objektiviteti në trajtimin e çështjes.

Në fund ka kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës L.K, për shkak të shkeljes së Kodit Etik të gjyqtarëve, konkretisht për shkak të komunikimit me prokurorin pa i njoftuar palët e tjera me përmbajtjen e letrës, ndërhyrjen në deklaratën e të dëmtuarës duke u munduar të interferoj, trajtim i pabarabartë i palëve në procedurë duke hyrë nga hyrja e njëjtë me trupin gjykues, trajtim i pabarabartë i propozimeve etj.

Gjyqtarja e çështjes L.K, lidhur me kërkesën e lartcekur të ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit, ka theksuar se lidhur me pretendimin e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit F.M, avokat F.L, se kryetarja e trupit gjykues ka pranuar një letër nga prokurori i rastit R.S, kjo nuk është e konstatuar në procesverbal, e as ndonjë vërejtje nga ana e mbrojtësit se ai e ka parë prokurorin se ka dorëzuar diçka lidhur me këtë lëndë. Meqë ka kaluar një kohë sipas saj ka mundësi që prokurori të ketë dorëzuar ndonjë letër për ndonjë lëndë tjetër ose shënim për ndonjë çështje, por jo lidhur me këtë lëndë penale, sepse në të kundërtën kjo letër do të ishte pjesë e shkresave të lëndës. Në lidhje me këtë e njëjta ka deklaruar se ky fakt nuk i kujtohet as anëtarëve të trupit gjykues që prokurori të ketë dorëzuar ndonjë letër që është relevante për rastin. Tutje ka shtuar se sa i përket udhëheqjes së seancës gjyqësore Kodi i Procedurës Penale e parasheh që udhëheqjen e seancës e bën kryetari i trupit gjykues dhe kjo ka ndodh edhe në rastin konkret ku kryetarja e trupit gjykues është kompetente për udhëheqjen e seancës dhe konstatimet në procesverbal. Procesverbalit i datës 30.11.2023 u është dorëzuar të gjitha palëve, mbrojtësi dhe të gjitha palët e kanë nënshkruar pa vërejtje këtë procesverbal. Sipas saj, mbrojtësi i të akuzuarit avokat F.L asnjëherë në seancat e radhës nuk ka paraqit ndonjë vërejtje sa i përket përmbajtjes së procesverbalit të dt.30.11.2023 dhe pretendimet e mbrojtësit në këtë fazë të procedurës penale ku lënda është në përfundim nuk përbëjnë asgjë tjetër përveç se spekulim, duke u përpjekur të ngrit dyshime për të krijuar një pretekst për të vënë në dyshim paanshmërinë e kryetares së trupit gjykues dhe anëtarëve të trupit gjykues. Tutje ka shtuar se sa i përket pranueshmërisë së provave ato janë objekt i vendimmarrjes së trupit gjykues dhe si të tilla mbrojtja ka të drejtë ti sfidoj përmes mjeteve juridike në shkallë më të lartë. Duke qenë se provat janë objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar, atëherë e njëjta ka deklaruar se kufizohet që të jap ndonjë koment lidhur me provat. Në fund

ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit për komunikim me të dëmtuarën, kjo nuk ka ndodhë asnjëherë, as nga kryetarja e trupit gjykues e as nga anëtarët e trupit gjykues. Prandaj kryetarja e trupit gjykues nuk e kundërshton shikimin e kamerave, sepse ne nuk e dimë se kah ka hy e dëmtuara në sallën e gjykimit, por trupi gjykues asnjëherë nuk ka hy në sallë paralel me të dëmtuarën, trupi gjykues e ka gjet të dëmtuarën në sallë të gjykimit.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares L.K.

Në referim të pretendimit të theksuar në kërkesën e parashtruar nga av. F.L se në seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë ndodhur pa rregullsi nga kryetarja e trupit gjykues ku sipas tij prokurori i shtetit gjatë një pauze të shkurtë në seancën e datës 30.11.2023 i ka dorëzuar një letër kryetares së trupit gjykues për të cilën letër palët nuk janë njoftuar, a po pretendimi tjetër se Kryetarja e trupit gjykues ka insistuar disa herë në përgjigjen e dhënë nga dëshmitarja në lidhje me një datë të caktuar të cilën e njëjta e ka deklaruar, a po se pala e dëmtuar në gjykatore ka hyrë në seancë së bashku me trupit gjykues nga hyrja zyrtare dhe jo nga hyrja e palëve, Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se pretendimet e avokatit janë të pa bazuara meqenëse nga koha kur avokati ka pretenduar se janë bërë këto shkelje ka kaluar një kohë e gjatë dhe të njëjtat nuk janë raportuar, por as nuk janë evidentuar në procesverbale gjyqësore të seancave të mbajtura në datat 30.11.2023, 08.12.2023, 24.01.2024 dhe datës 22.02.2024, e që gjykata të vetmen mundësi për të vërtetuar këto rrethana e ka procesverbalin dhe në bazë të procesverbaleve të këtyre datave, nuk shihet që ka pas vërejtje nga avokati në fjalë në lidhje me ndonjë veprim të caktuar të kryetares apo anëtarëve të trupit gjykues, i cili sipas legjislacionit në fuqi në çdo rast kur ka vërejtje a po dyshim në lidhje me veprimet gjatë seancave gjyqësore, është i lirë që vërejtjet ti paraqet në procesverbal që të njëjtat të janë si provë të cilat do të shërbenin për rastin konkret a po për procedurë tjetër. Andaj, meqenëse avokati në fjalë nuk ka paraqitur prova që të mbështesë pretendimet e tij ndërsa këto pretendime janë mohuar nga kryetarja e trupit gjykues, pretendimet e tilla mbeten të pavërtetuara dhe si të tilla të pabazuara.

Ndërsa pretendimet e avokatit F.L se kryetarja e trupit gjykues gjatë gjithë marrjes në pyetje të palës së dëmtuar nga ana e avokatit mbrojtës të pandehurit ka ndërhyrë në pyetje dhe i ka ndaluar të njëjtin të bëjë pyetje, Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht nenit 296 par.2 të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues ka autoritetin e plotë dhe ekskluziv në menaxhimin e seancës gjyqësore, duke u detyruar të kujdeset për mbajtjen e rendit në gjykatore por edhe dinjitetin e gjykatës. Por po ashtu, as në lidhje me këtë pretendim në procesverbalet e seancave gjyqësore nuk është evidentuar asnjë vërejtje e dhënë nga avokati në fjalë, përkundrazi procesverbali në fjalë është nënshkruar nga të gjitha palët pa asnjë vërejtje.

Sa i përket pretendimeve të avokatit se kryetarja e trupit gjykues ka refuzuar të gjitha propozimet e dhëna nga i njëjti, Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarëve lidhur me vendimet për propozimet e paraqitura nga palët në procedurë, a po nëse këto veprime të gjyqtares bien ndesh me dispozitat e procedurës penale, pasi që për shkelje të dispozitave të procedurës penale vendos shkalla më e lartë me rastin e atakimit të vendimit.

Kryetarja e Gjykatës po ashtu nuk u lëshua në vërtetimin e pretendimit se nga cila hyrje ka hyrë a po dal e dëmtuara në seanca gjyqësore, pasi që kryetarja e trupit gjykues a po anëtarët, nuk janë përgjegjës për sigurinë e objektit a po që të udhëzojnë palët se nga cila hyrje duhet të hyjnë në seancë, a po në cilin korridor të objektit palët duhet të qëndrojnë. Në lidhje me këtë ekziston sigurimi i gjykatës, të cilët janë përgjegjës për udhëzimin e palëve a po orientimin e tyre në objekt.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, respektivisht nga parashtruesi i kërkesës nuk janë provuar me asnjë provë të vetëm pretendimet e paraqitura, e të njëjtat janë mohuar nga kryetarja e trupit gjykues, mohime këto që janë të mbështetura edhe në shkresat e lëndës, respektivisht procesverbalet gjyqësore.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/05/24, me datë 27.03.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë